



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.8.1-2018-08

**RAPORTI AUDITIMIT PËR KOMUNËN E OBILIQIT
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Komunës së Obliqit* në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Luljeta Sylaj*, udhëheqës ekipi dhe anëtarët *Alban Beka* dhe *Syeda Oruçi*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Zukë Zuka*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm.....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	22
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	25
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	31
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	33

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Obiliqit për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore . Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 15/01/2019.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, përmendim faktin se shpenzimet në vlerë 102,040€ ishin realizuar dhe raportuar gabimisht nëpër kategori ekonomike.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Drejtori për Buxhet dhe financa (i cili luan rolin e Zyrtarit Kryesor Financiar).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregulloren (LMFPP), Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet në vlerë 102,040€ ishin realizuar dhe raportuar gabimisht nëpër kategori ekonomike. Dhe atë si në vijim:

- Pagesat për shpenzime komunale (rrymë) në vlerë 33,397€ ishin shpenzuar nga kategoria e investimeve kapitale, Ndërsa, shpenzimet për subvencionim e Caritas Kosova, për ngritje të kujdesit shëndetësorë, në vlerë 29,767€ ishin buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale;

- Po ashtu 27,370€ ishin buxhetuar dhe shpenzuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve e që kishin të bënin me subvencionimin e shpenzimeve të varrimit;
- Vlera prej 5,610€ ishte shpenzuar nga mallrat për pagesën e orëve shtesë të stafit, e do të duhej të paguhej nga kategoria e pagave dhe mëditjeve; dhe
- Vlera prej 5,895€ ishte shpenzuar nga kategoria mallra dhe shërbime derisa kishte të bënte me Investime kapitale, kryerjen e disa punëve në objektin e Komunës.

Sipas komunës klasifikimi kishte ndodhur si pasojë e rritjes së shpenzimeve për ndriçimin e rrugëve dhe mungesës së buxhetit në kategoritë përkatëse. Megjithatë kjo është e ndikuar edhe nga dobësitë në planifikimin buxhetorë. Opinioni jonë nuk është i modifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës së Obiliqit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 (shpenzimet publike) dhe 02/2013 (Menaxhimi i pasurisë);
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raportet tremujore dhe mujore për faturat e papaguara dhe të hyrat; dhe
- Planin e prokurimit dhe raportin për kontratat e nënshkruara.

Lidhur me PFV, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Në PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare, të cilat janë përmirësuar në PFV finale. Megjithatë, sfiduese mbetet keqklasifikimi i shpenzimeve.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, konsiderohet e saktë.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të angazhohet që gjatë planifikimit të buxhetit për organizatën të vlerësohen nevojat reale të komunës me qëllim që të bëhet një planifikim adekuat i buxhetit dhe të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve nëpër kategori përkatëse ekonomike.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Obiliqit kishte shpenzuar 87% të buxhetit final për vitin 2018, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm, megjithëse sfidë mbetet niveli i realizimit të investimet kapitale. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme, megjithatë nevojiten përmirësime tek mekanizmat për arkëtimin e të arkëtueshmeve. Po ashtu fusha e investimeve kapitale dhe rekrutimet e stafit kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	6,851,926	7,354,681	6,387,148	5,870,255	5,511,351
Granti i Qeverisë -Buxheti	5,909,763	5,897,985	5,613,954	5,090,813	4,241,691
Të bartura nga viti paraprak ²	-	396,610	169,938	133,548	515,298
Të hyrat vetjake ³	876,728	912,880	530,367	548,797	725,279
Donacionet e brendshme	0	25,247	18,705	5,842	7,738
Donacionet e jashtme	0	50,634	50,634	91,255	21,345
Financim nga Humarrja	65,434.60	71,325	3,550	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 502,755€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të brendshme dhe të jashtme, të hyrave të bartura nga viti paraprak.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Në vitin 2018 komuna ka shpenzuar 87% të buxhetit final ose 6,387,148€, që krahasuar me vitin e kaluar ka një rënie në shkallën e realizimit për 4%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	6,851,926	7,354,682	6,387,148	5,870,255	5,526,498
Pagat dhe Mëditjet	3,875,959	3,878,181	3,833,181	3,695,367	3,673,058
Mallrat dhe Shërbimet	549,877	595,663	520,242	350,052	372,479
Shërbimet komunale	123,000	149,015	148,160	167,628	116,453
Subvencionet dhe Transferet	138,799	143,377	139,930	135,981	133,127
Investimet Kapitale	2,164,291	2,588,446	1,745,635	1,521,227	1,231,381

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur janë:

- Pavarësisht se gjatë vitit buxheti për shpenzime kapitale ishte rritur për 424,155€, si rezultat i të hyrave të bartura nga viti kaluar dhe grandeve, vetëm 67% e tij ishte shpenzuar. Programi për Investime Publike ka përfshirë 30 projekte, 8 projekte ishin realizuar më pak se 75 %, derisa projekti për hartën zonale nuk po arrin të realizohet. për të cilin janë planifikuar 50,000€;
- Buxheti për paga dhe mëditje nga ai fillestarë kishte një rritje prej 2,222€, nga të hyrat e bartura nga viti 2017 për mbulimin e kujdestarive në shëndetësi;
- Mjetet e buxhetuara për mallra dhe shërbime ishin rritur për 45,786€, nga të hyrat e bartura nga viti 2017 prej 24,100€, nga të hyrat e këtij viti 18,152€ dhe nga fondi i huamarrjes 3,534€. Buxheti i kësaj kategorie kishte arritur të shpenzohet 87%;
- Buxheti për komunalitë ishte rritur për 26,015€. Mirëpo as kjo shumë nuk kishte mjaftuar për të paguar borxhet që ka komuna ndaj komunalive. Gjatë vitit 33,397€ janë paguar nga kategoria e IK përmes përmbaruesit për të shlyer obligimet e rrymës. Po ashtu borxhe në vlerë prej 77,976€ kanë mbetur obligime për vitin 2019; dhe
- Buxheti final tek subvencionet dhe Transferet ishte rritur për 4,578€, nga të hyrat vetanake të vitit të kaluar. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 97%.

Çështja B1⁴ - Realizimi i buxhetit

- Gjetja** Për 24 projekte kapitale të buxhetura komuna ka shpenzuar vetëm 67% të buxhetit të Investimeve Kapitale. Si pasojë e kësaj kanë mbetur pa u realizuar në tërësi disa projekte si: gjelbërimi i sipërfaqeve, kanalizimi, disa rrugë, etj. Komuna e pranon këtë sfidë, për të cilën sipas saj shkaktarë janë inicimi dhe lidhja e kontratave me vonesë si dhe mos përmbushja e kontratave në tërësi. Për projektet e papërfunduara do të shpenzohen të hyrat e bartura apo buxheti i vitit 2019.
- Rreziku** Mos-përmbushja e programit për investimet kapitale mund të rezultojë në realizimin e më pak projekteve, dëmtimin e tyre meqë ngecin, gjë që ndikon direkt në mirëqenien e qytetarëve si dhe në cilësinë e shërbimeve.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2017 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2018. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Ndërsa, planifikimi dhe shpenzimi për projekteve të caktuara duhet të bëhet konform kodeve ekonomike të ndara për kategori përkatëse varësisht përfitimeve.

⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Çështja B2 - Pagesat direkte nga thesari

Gjetja Sipas neni 39.2 të LMFP, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara apo punët e realizuara për OB, duhet të paguhet brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës. Ndërsa sipas nenit 40 të LMFP, fatura mund të ekzekutohet direkt nga thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbaruesi.

Bazuar në kriteret e mësipërme, Thesari kishte ekzekutuar pagesa në vlerë prej 62,538€ nga buxheti i komunës direkt në llogari të Operatorit Ekonomik (OE)/Përmbaruesit. Punët ishin të përfunduara, mirëpo nuk ishin paguar sipas procedurave të rregullta për shpenzimin e parave publike. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së mjeteve buxhetore për shpenzimet përkatëse. Ekzekutimi i këtyre pagesave kishte shkaktuar shpenzime shtesë për 9,000€.

Rreziku Format e pagesës përmes vendimeve gjyqësore, rrezikojnë realizimin e projekteve të planifikuara kapitale apo realizimin e shërbimeve nga ku janë marrë mjetet për pagesë. Pagesat e tilla shkaktojnë dëmtim shtesë të buxhetit për shkak të shpenzimeve përmbarimore.

Rekomandimi B2 Kryetari, duhet të siguroj kontrolle, përgjegjshmëri më të lartë ndaj kryerjes së obligimeve me kohë ndaj operatorëve, si dhe të shmang hyrjen në obligime në mungesë të mjeteve apo kontratës. Gjithashtu, gjatë planifikimit buxhetor, të bëhet një vlerësim i shumave të mundshme të daljes së parasë nga kontestet gjyqësore dhe këto të planifikohen në kuadër të buxhetit vjetor, në mënyrë që mos të rrezikohet realizimi i projekteve tjera të planifikuara.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat vetanake administrohen dhe arkëtohen nga vetë administrata komunale, ku si qëllim kryesor është shpenzimi këtyre mjeteve për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarin. Të hyrat vetanake, janë burime të rëndësishme të ardhurave komunale.

Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2018 ishin në vlerë 917,275€. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë 47% të totalit, ndërsa pjesën tjetër të hyrat nga taksa për regjistrimin e trashëgimisë, taksat administrative, taksa për ushtrimin e veprimtarisë, lejet e ndërtimit etj. Po ashtu komuna ka pranuar të hyra nga gjobat në trafik 93,072€ dhe prej gjobave nga gjykata 100€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Tatimi në Pronë	368,959	421,667	431,175	333,395	328,871
Taksa komunale	507,769	415,986	486,100	558,453	453,926
Totali	876,728	837,653	917,275	891,848	782,797

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave, nënshkrimin e listave të pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, azhurnimin e dosjeve të personelit si dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin. Për vitin 2018 buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 3,878,180€ me një shpenzim prej 3,833,181€, duke rezultuar me një realizim prej 99% të buxhetit të ndarë.

Çështja A2 - Mangësi në rekrutimin e mësimeve

Gjetja Sipas UA 17/2009 (MASHT) "Procedura e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë", neni 4.2 Komisioni për zgjedhjen e personelit arsimor do të shqyrtoj të gjitha kërkesat e kandidatëve, dhe në bazë të kriterëve të përcaktuara do të përpilohet lista e ngushtë prej tre (3) kandidatëve për intervistë. Në konkursin për dy (2) mësues klase në SHFMU "Fazli Grajqevci" kishin aplikuar 15 kandidatë, ndërsa komisioni kishte përfshirë në listë të ngushtë tre (3) prej tyre, për të cilët nuk kishim dëshmi rreth përzgjedhjes së tyre. Jashtë listës së ngushtë kishin mbetur kandidatë me më shumë përvojë pune. Sipas zyrtarëve nga Drejtoria e Komunale e Arsimit (DKA), për listën e ngushtë iu kishte dhënë përparësi banorëve të Komunës së Obiliqit, bazuar në Ligjin për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit, edhe pse ky kriter nuk ishte paraqitur në konkurs.

Në rastin tjetër, sipas UA 10/2018 "Për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm", Institucionet edukative dhe arsimore gjatë publikimit të konkurseve për vendet e lira të punës, për arsimin fillor kërkohet Fakulteti i Edukimit- programi fillor ose Fakulteti i Mësuesisë. Në konkursin për 1 (një) mësues klase në SHFMU "Naim Frashëri" në Breznicë ishte përzgjedhur kandidatja edhe pse nuk e kishte të përfunduar fakultetin. Sipas zyrtarëve nga DKA fillimisht ishte përzgjedh një kandidat i cili i kishte plotësuar kriteret mirëpo nuk ishte paraqitur në punë dhe në mungesë të kandidateve të tjerë kishin vendosur që deri në përfundim të vitit shkollor ta angazhojnë këtë kandidat.

Rreziku Mos respektimi i udhëzimeve në fuqi rrit rrezikun për diskriminim të kandidatëve, dhe pranim të kandidatëve jo kompetent për pozitat adekuate, me të cilin rast dëmtohen palët përfituese e në këtë rast nxënësit.

Rekomandimi A2 Kryetari të sigurojë se janë dizajnuar kontrollet e duhura në mënyrë që rekrutimet të behen përmes një procesi transparent, konkurrues dhe në pajtim me kërkesat ligjore. Në rastet kur ka deficit të burimeve njerëzore, kjo duhet të konsultohet me organet përkatëse qendrore (ministrinë përkatëse) dhe rastet e tilla të rregullohen përmes bazës rregullative.

Çështja C1 - Marrëveshjet për shërbime të veçanta

- Gjetja** Sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, neni 12, pika 4 dhe Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, neni 10, lejohet lidhja e kontratave për shërbime të veçanta dhe detyra specifike. Në bazë të kësaj komuna për realizimin e shërbimeve të domosdoshme, kishte angazhuar 34 persona përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MShV). Angazhimi i tyre ishte bërë përmes procedurave të thjeshtëzuara të rekrutimit. Nga nëntë (9) rastet e testuar në katër (4) prej tyre personat ishin angazhuar në pozita të rregullta të punës. Të njëjtit persona kryenin detyrat e tyre përmes këtyre kontratave edhe në vitin paraprak. Ky staf ishte angazhuar në pozita të ndryshme, zyrtarë transporti, lektorë, mirëmbajtës, etj. Sipas komunës kjo ishte pasojë e mungesës së pozitave të aprovuara në planifikimin e buxhetit.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave me marrëveshje të përkohshme rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rritë pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi meritator.
- Rekomandimi C1** Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 595,663€. Prej tyre ishin shpenzuar 520,224€, apo 87% e tij. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këtë kategori përfshijnë, shpenzimet komunale, shpenzimet kontraktuese tjera, derivatet dhe dru për ngrohje, mirëmbajta rutinore, mirëmbajtje e veturave, furnizime mjekësore, etj. Gjetjet për këtë kategori kanë të bëjnë me keq klasifikimet dhe janë te prezantuar të theksimi i çështjes.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 143,377€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 139,929€, apo 97%. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e aktiviteteve kulturore dhe sociale, fermerëve, bursa të studentëve dhe nxënësve, si dhe mbështetje individuale për shërim, etj. Gjetjet për këtë kategori kanë të bëjnë me keq klasifikimet dhe janë te prezantuar të theksimi i çështjes.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Për vitin 2018, buxheti final i investimeve kapitale ishte 2,588,446€ dhe shpenzimi 1,745,635€ apo 67%. Vitin e kaluar shkalla e realizimit ishte 75%. Përderisa Programi për Investime Publike (PIP) përfshin 30 projekte, 12 prej tyre janë realizuar në shkallën 80% e më pak. Po ashtu, nga kjo kategori janë ekzekutuar pagesa direkte nga Thesari, bazuar në nenin 39.2 dhe 40 të LMFPP-së, për shpenzime komunale.

Çështja A3 – Procedurat për punët shtesë

Gjetja Kontrata është marrëveshje detyruese mes palëve sipas së cilës krijohen detyrime dhe të drejta për palët nënshkruese, para se të fillohet puna apo shërbimi. Komuna kishte lidhur aneks kontratë për projektin “Ndërtimi i urës në Fshatin Plemetin”, në vlerë 31,200€ pas përfundimit të punëve. Këto punë, sipas dokumentacionit nuk ishin të parashikuara, mirëpo të domosdoshme për realizimin e projektit. Punët kishin qenë të aprovuara nga menaxherët e kontratës, dhe për to ishte marrë oferta më e lirë. Sipas komunës aneks kontrata nuk kishte mundur të lidhet me kohë për shkak të mungesës së mjeteve të buxhetuara.

Rreziku Kryerja e punëve shtesë para aneks kontratës, mund të ndikoj në kosto shtesë, apo të mos merr vlerën për paratë e shpenzuara. Në anën tjetër, në rast se pala nuk kompensohet me kohë, vie deri te penalizimet nga ana e Operatorit Ekonomik.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë mjetet e nevojshme për realizimin e projekteve, në anën tjetër të sigurojë se punëve shtesë iu paraprinë aneks kontrata që përcakton saktë kushtet dhe çmimet e punëve apo shërbimit të përfituar.

Çështja A4 - Mos aplikimi i librit ndërtimor

Gjetja Sipas Ligjit 04/L - 110 për Ndërtim, neni 26 pika 1.5, kontraktuesi në vend ndërtim duhet të ketë ditarin dhe librin ndërtimor. Në të gjitha projektet e realizuara kemi vërejtur se është mbajtur vetëm ditari e jo libri ndërtimor. Sipas Drejtorit për Infrastrukturë Lokale menaxheret e projektit nuk e kanë kërkuar librin ndërtimor por vetëm ditarin për arsye se ata kanë raportuar direkt tek drejtori dhe kryetari dhe e kishin anashkaluar këtë kërkesë ligjore.

Rreziku Mos aplikimi i librit ndërtimor rrit rrezikun e mos transparencës së nevojshme lidhur me realizimin e projektit sipas planifikimit, ngase ai duhet të jetë në vend punishte në rast të inspektimit të projektit për mbarëvajtjen e tij.

Rekomandimi A4 Kryetari të sigurojë se menaxheret e projektit kërkojnë nga kontraktuesit aplikimin e librit ndërtimor, si mjet për ndërtim dhe zhvillim të projektit.

Çështja A5- Mos planifikim i duhur i projekteve

Gjetja Sipas kontratës, për projektin “Rregullimi i rrugëve me kubëza- Murat Krasniqi; Presheva; Naser Kastrati; Kongresi i Manastirit; 11 Qershori” ishin paraparë që të shtohen me kubëza pesë (5) rrugë, në vlerë 85,635€. Gjatë ekzekutimit të saj për tri (3) rrugë banorët nuk kishin lejuar kryerjen e punimeve pasi që në projekt nuk ishte paraparë realizimi i kanalizimit fekal. Komuna me pëlqimin e OE kishte bërë ndërprerjen e kontratës dhe kontrata ishte realizuar vetëm për dy (2) rrugë. Shkak i kësaj ishte ekzistimi i kanalizimit të vjetër, por i cili nuk i përmbushte nevojat e qytetarëve.

Në rastin tjetër, kontrata “Rregullimi i kanalizimit fekal pjesa e parë” në vlerë 55,366€ ishte paraparë rregullimi i kanalizimit për 11 vende, mirëpo në dy (2) prej tyre nuk ishte realizuar për shkak të problemeve pronësore dhe se banorët kanë kërkuar që ujërat atmosferike të futen në gypa.

Rreziku Nënshkrimi i kontratave pa planifikim të duhur dhe pa zgjidhur çështjet pronësore shkakton barrë për buxhetin e vitit vijues, e mbi të gjitha dëmton perceptimin e qytetarëve ndaj e komunës.

Rekomandimi A5 Kryetari të siguroj se para fillimit të procedurave të janë planifikuar projektet në tërësi, të zgjidhen të gjitha çështjet pronësore, në mënyrë që të mos ketë ngecje të projekteve dhe të pa realizuara.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj. Krahasuar me vitin e kaluar komuna ka bërë progres thelbësor sa i përket menaxhimit të pasurisë.

Në fund të vitit 2018 vlera neto e pasurive kapitale jo financiare ishte 45,535,222€ derisa në vitin paraprak ishte 12,960,601€. Rritja e vlerës së pasurive, përveç regjistrimeve të pasurive të vitit aktual vie për shkak të regjistrimit të pasurisë nga vitet e kaluara sipas rekomandimit nga ZKA. Komuna gjithashtu ka paraqitur vlerën e pasurive nën 1,000€ sipas raportit nga E-pasuria në vlerë 178,381€ si dhe stoqet 137,232€.

Megjithatë, sipas rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive, neni 6 thekson se secila OB duhet të krijojë dhe azhurnojë regjistrin e pasurive. Derisa, objekti i vjetër i Komunës ishte rrënuar sipas vendimit të Kuvendit Komunal gjatë muajit nëntor 2018, ai nuk ishte fshirë nga regjistri i pasurisë. Vlera e tij ishte 106,517€. Mirëpo gjatë periudhës së auditimit komuna, në shkurt 2019 ka bërë korigjimin dhe kjo pasuri është fshirë nga sistemi (regjistri i pasurisë).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paraja e gatshme apo Paratë e imta janë fond i vogël i parave që mbahet në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njësisive më të vogla buxhetore varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme (LLA) në fund të vitit 2018 ishte në vlerë 1,099,339€, të cilat kishin të bënin me tatimi në pronë, ndërrimin e destinimit të tokës, taksa në firmë, shitja e banesave, qiraja komunale dhe shfrytëzimi i hapësirës publike.

LLA nga Tatimi në Pronë përbën 63% të totalit të borxheve. Komuna në vitin 2018 ishte angazhuar maksimalisht në mbledhjen e këtyre borxheve, si dhe kishte lëshuar disa vërejtje si masë për inkurajimin e të gjithë obliguesve të komunës që të paguajnë obligimet e tyre, megjithëse disa prej tyre i ishin përgjigjur pagesave edhe më tutje ky borxh mbetet shqetësues. Përmes vërejtjeve Komuna kishte arritur të mbledh 50,941€ borxhe të vjetra të Tatimit në Pronë.

Çështja B3 – Sfidat në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 23 të ligjit Nr . 06L/005⁵ për tatimin në pronën e paluajtshme, sipas kontratave të nënshkruara për qira dhe blerje banese, dhe sipas aktvendimeve për bërje biznesi secila palë është e detyruar që të paguaj obligimin ndaj komunës në afatet e përcaktuara. Përkundër kësaj, kjo situatë është mjaft sfiduese për komunën e cila duhet të rrisë përpjekjet e arkëtimit në disa drejtime. Testimi i mostrave tona në këtë fushë ka identifikuar si:

- Gjatë testimit të 24 mostrave për Tatimin në pronë ne kemi rikonfirmuar borxhin e tatimpaguesve të paraqitur në PVF, vetëm në këto mostra borxhi

⁵ Neni 23 i ligjit Nr. 06L/005, pika (2) 2. specifikon “Për vitin tatimor 2018, kësti i dytë i tatimit në pronën e paluajtshme paguhet deri më 31 dhjetor të atij viti tatimor, sipas Ligjit Nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-100.

ishte 106,961€. Sipas komunës edhe pse në vitin 2018 kishin lëshuar vërejtje dhe janë përgjigjur disa qytetarë, përsëri ky borxh nuk po mund të arkëtohet në shkallë të kënaqshme;

- Tek dy mostrat e testuara për qiratë e lokaleve, borxhi ishte 3,104€, edhe pse shfrytëzuesit e lokaleve nuk e kishin kryer obligimin atyre iu kishte dhënë përsëri kontrata e qirasë. Sipas zyrtarëve qiramarrësit kishin paguar një shumë të mjekteve para marrjes së lokalit me qira dhe ishin zotuar për pagesa tjera, gjë që nuk ka ndodhur;
- Tek mostra e testuar për shfrytëzimin e hapësirës komunale, edhe pse borxhi total i shfrytëzuesit ishte 4,320€, i njëjti vazhdon të shfrytëzojë këtë pronë pa kryer asnjë obligim. Komuna i kishte dërguar një vërejtje por ai nuk iu kishte përgjigjur;
- Nga 510 biznese borxhi total ishte 101,990€ dhe i njëjti ishte rritur për 23,845€ krahasuar me vitin e kaluar. Komuna gjatë vitit 2018 kishte lëshuar vërejtje ndaj subjekteve afariste të cilat nuk iu kishin përgjigjur borxhit, por kjo nuk kishte dhënë rezultat. Po ashtu sipas komunës në listë figurojnë edhe bizneset të cilat nuk ekzistojnë më, mirëpo pronarët nuk e informojnë komunën për biznesin joaktiv; dhe
- Nga shitja e banesave që kishte ndodhur në vitin 2015, komuna nuk po arrin të inkason të hyra, borxhi total është 72,352€. Shkak i kësaj është pamundësia e blerësve që të bartin pronësinë tek ta. Komuna ende nuk ka marrë ndonjë vendim për këta borxhlinjë.

Rreziku

Niveli i lartë i të arkëtueshmeve mbetet sfidë edhe për periudhën e ardhshme. Niveli i lartë i të arkëtueshmeve, rrezikon që ato të bëhen të pa mbledhshme duke krijuar një rast precedent për borxhlinjtë e tjerë të cilët mund të ndjehen të trajtuar në mënyrë jo të barabartë dhe që rezulton në një humbje të drejtpërdrejtë financiare për komunën.

Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Po ashtu komuna duhet të shqyrtojë mundësinë e përdorimit të një softueri për menaxhimin e tyre.

3.5 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 151,991€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019 e që kishin të bënin me obligime për mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe investime kapitale. Pjesën më të madhe të borxhit apo 51% të tij e përbejnë shpenzimet komunale.

Në anën tjetër Komuna zbaton një proces relativisht të rregullt të raportimit të obligimeve. Drejtoritë në përgjithësi janë të vetëdijshme për kërkesat e rregullores për raportim të faturave të papaguara si dhe zyrtari përgjegjës raporton me kohë në Thesar në lidhje me këtë.

Derisa në lidhje me pretendimet e palëve tjera ndaj komunës, në bazë të kontesteve aktuale gjyqësore, komuna ka listuar disa raste të mundshme me një shumë të vlerësuar prej 1,494,049€.

Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna, e cila duhet të kryej këto obligime para se të bëjë pagesat tjera për vitin 2019, apo dëmet në rast të fitimit të kontesteve gjyqësore nga palët.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në Komunën e Obiliqit krahasuar me vitin e kaluar është vërejtur një angazhim i shtuar i kryetarit dhe stafit përcjellës drejt sigurimit të shërbimeve dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve të kësaj komune. Në këtë vit është punuar për shtimin e buxhetit të kësaj komune, çka edhe ka ndodhur. Në vitin 2019 Komuna e Obiliqit do të ketë buxhet prej rreth 12 mil.⁶€ apo 100% më shumë se në vitin 2018. Po ashtu, përgjigja me përkushtim ndaj rekomandimeve të auditimit, funksionimi i mirë i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, krijimi i Komitetit të Auditimit, hartimi i listës së rreziqeve, hartimi i Rregullores së brendshme për menaxhimin e pasurisë, janë vetëm disa nga hapat drejt angazhimit dhe përmirësimit të qeverisjes në komunë.

Megjithëse, realizimi i buxhetit tek projektet kapitale, menaxhimi i tyre dhe iniciativat për mbledhjen e të hyrave komunale edhe më tutje mbesin fusha sfiduese për komunën.

Sa i përket planeve strategjike, të gjitha komunat janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin ato në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Komuna e Obiliqit posedon disa nga këto plane mirëpo të njëjtat duhet të azhurnohen dhe ndryshohen pas hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe të Hartës zonale të cilat janë të obliguara me Ligjin për planifikimin hapësinorë. Aktualisht komuna ka Strategjinë për Zhvillim Socio Ekonomik lokal 2017-2021 dhe Planin Zhvillimor Komunal 2016-2025, i cili duhet të ndryshohet. Gjatë vitit 2018 komuna kishte dështuar në lidhjen e kontratës për Hartimin e planit zhvillimor komunal, meqë procedura e prokurimit ishte anuluar dy herë.

⁶ <https://mf.rks.gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një anëtarë të stafit – UD/ Drejtori i NjAB. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Komuna e Obiliqit ka krijuar Komitetin e Auditimit tek në janarin e vitit 2019, andaj nuk ka mundur të ofrojë ndihmën e tij për NJAB-në. KA është organ këshillëdhënës dhe mbështetës për auditorët e brendshëm për të përmbushë sa më mirë funksionin e tyre dhe për të ruajtur pavarësinë.

Çështja A6 – Funkionimi i NJAB

Gjetja Sipas udhëzimit administrativ 23/2009⁷, Neni 3, përcakton që secila organizatë me buxhet 3 deri 5 milionë euro duhet të ketë së paku dy auditorë të brendshëm. Derisa në vitin 2019, komuna ka një buxhet mbi 12 milion euro. Komuna aktualisht ka vetëm një Auditorë dhe atë në cilësinë e Drejtorit të NJAB-së. Si pasojë kjo njësi nuk ka arritur të përmbush planin e saj vjetor, nga 7 auditime dy nuk ka arritur ti përfundojë. Njëri auditimi i rëndësisë së madhe ngase kishte të bënte me prokurimin. Kufizimi në rekrutimin e një stafi të ri vjen si shkak i asaj se në listën e pagave te komunës figuron auditori i brendshëm i cili aktualisht është në pension të parakohshëm. Në anën tjetër komuna ende nuk ka bërë kërkesë për shtimin e stafit tek kjo njësi.

Rreziku Angazhimi i vetëm një auditori në një komunë, mund të ndikoj që NJAB mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të konsiderojë që me krijimin e kushteve buxhetore, të planifikojë staf shtesë në NjAB me qëllim të funksionalizimit të plotë të kësaj njësie dhe të realizimit të planit vjetor. Njëkohësisht, që NJAB të përfshijë më shumë auditime me qëllim të përmirësimit të efikasitetit në procesin e menaxhimit të rrezikut, kontrolleve dhe qeverisjes.

⁷ UA 23/2009 Për themelimin dhe funksionimin e Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara nuk janë plotësisht efektive.

Çështja B4 - Mangësi tek kontrollet menaxheriale

Gjetja Si pasojë e kontrolleve të pamjaftueshme menaxheriale, buxheti për investime kapitale ishte në nivel të ultë dhe pagesave të konsiderueshme ishin bërë në tremujorin e fundit të vitit, apo 41% e buxhetit. Po ashtu menaxhimi i të arkëtueshmeve nuk ishte në nivelin e duhur. Menaxhmenti duhet të bëjë analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, të rishqyrtojnë planin e prokurimit si dhe arkëtimin e të hyrave.

Sipas rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, komuna duhet të ketë një sistem për menaxhim të rreziqeve, ky sistem ishte vendosur mirëpo nuk ishte monitoruar.

Rreziku Kërkesat jo të forta të llogaridhënies dhe raportimi financiar duhet të forcohen për të ndikuar në efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë.

Rekomandimi B4 Kryetari, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, të arkëtueshmet, shpenzimet e IK, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të monitorojë listën e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Komunës së Obiliqit ka rezultuar në 20 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Raporti i AP-së edhe se ishte futur në rend dite nuk ishte diskutuar në Asamblenë Komunale, po ashtu edhe progresi i zbatimit të Planit të Veprimit për rekomandimet e dhëna nuk është diskutuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, 13 rekomandime janë zbatuar; një ishte në proces, katër (4) nuk janë adresuar ende, derisa dy rekomandime janë të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryetari duhet të siguroj se janë analizuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për ta konfirmuar menaxhimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë, përfshirë edhe shpalosjen e drejtë të tyre në PFV.</p> <p>Po ashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>	Çështjet për të cilat ishte theksuar opinionin e auditimit vitin e kaluar ishin zbatuar plotësisht, regjistri i pasurisë ishte azhurnuar.	Rekomandimi është zbatuar.
2	Procesi i buxhetit	<p>Kryetari, duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2017 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2018. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Ndërsa, planifikimi dhe shpenzimi për projekteve të caktuara duhet të bëhet konform kodeve ekonomike të ndara për kategori përkatëse varësisht përfitimeve.</p>	Nuk ka veprime për vitin 2018.	Rekomandimi i pa zbatuar.

3	Pagesat nga Thesari	Kryetari, duhet të siguroj kontrolle, përgjegjshmëri më të lartë ndaj kryerjes së obligimeve me kohë ndaj operatorëve, si dhe të shmang hyrjen në obligime në mungesë të mjeteve apo kontratës. Gjithashtu, gjatë planifikimit buxhetor, të bëhet një vlerësim i shumave të mundshme të daljes së parasë nga kontestet gjyqësore dhe këto të planifikohen në kuadër të buxhetit vjetor, në mënyrë që mos të rrezikohet realizimi i projekteve tjera të planifikuara.	Komuna nuk ka mundur të veproj për të përmirësuar situatën.	Rekomandi mi i pa zbatuar.
4	Të hyrat	Kryetari, duhet të përmirësoj procesin e verifikimit të pronave dhe të siguroj se verifikimi i 1/3-tës së pronave bëhet në baza të rregullta vjetore, në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.	Komuna kishte angazhuar ekipin në teren dhe ka arritur të kryej verifikimin e 1/3 të pronave.	Rekomandi mi është zbatuar.
5	Të hyrat	Kryetari, duhet të sigurojë që komuna si shitëse e banesave në përmbushje të dispozitave të ligjit 04/L061 të sqarojë me autoritetet relevante çështjen e pronësisë së banesave dhe të përmbyllë procesin e bartjes së pronësisë tek pronarët e rinj. Po ashtu, të aplikoj procedurat e nevojshme për regjistrimin e pronarëve në sistemin e tatimit në pronë.	Blerësit e banesave janë regjistruar në sistemin e tatimit në pronë.	Rekomandi mi i zbatuar.
6	Të hyrat	Kryetari, duhet të siguroj se asnjë pronë publike nuk do të lejohet të shfrytëzohet dhe keqpërdoret pa pagesën e qirave të parapara me kontratë. Duhet të gjenden forma që të merren masa të menjëhershme që detyrojnë obliguesit të respektojnë detyrimet kontraktuale.	Nuk ka asnjë qira të re, përveç atyre me ankand të cilët kanë paguar obligimin.	Rekomandi mi është zbatuar.
7	Të hyrat	Kryetari, duhet të sigurojë që kriteret për tarifën e përcaktuara në rregullore duhet të zbatohen sipas rasteve përkatëse, në mënyrë që të hyrat të arkëtohen në kohën dhe mënyrën e duhur, duke u qartësuar ngarkesat që iu takojnë obliguesve.	Në vitin 2018 nuk ka pasur fare të hyra nga ky kod.	Rekomandi mi është zbatuar.

8	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, duhet të sigurojë se Zyra e Burimeve Njerëzore dhe ajo e Financave kanë ndërmarrë hapat e duhur dhe në bashkëpunim me MAP-in të harmonizojnë në sistem të pagave koeficientët ashtu siç janë të lejuar me rregullat aktuale.	Kryetari ka marrë të gjitha masat, mirëpo në një rast procesi nuk ishte pranuar nga MAP. Meqë është futur në fuqi Ligji për pagat nuk kemi ngritur çështje të veçantë.	Rekomandi mi i mbyllur.
9	Menaxhimi i personelit	Kryetari, duhet të rishikojë shkaqet e anashkalimeve të tilla në procedurat e rekrutimit dhe të sigurojë forcimin e kontrolleve në këtë fushë, në mënyrë që procedurat e rekrutimit të zhvillohen konform rregullave të kërkuara.	DKA respekton rregulloren.	Rekomandi mi është zbatuar
10	MShV	Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit me MShV të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se janë marrë në konsideratë me rastin e planifikimit buxhetor, të trajtohen si të nevojshme dhe të diskutohen me MF.	Komuna për vitin 2018, kishte përdorur procedura të thjeshtëzuar të rekrutimit, mirëpo disa nga MSHV-të nuk ishin për pozita specifike por të rregullta.	Rekomandi mi pjesërisht i zbatuar
11	Mallra dhe shërbimet	Kryetari, duhet të forcojë kontrollet për të siguruar se kontratat publike nënshkruhen vetëm me operatorët që përmbushin në tërësi kriteret e kërkuara me dosje të tenderit.	Për secilën kontratë janë kërkuar referenca të mjaftueshme.	Rekomandi mi i zbatuar
12	Subvencionet dhe transferet	Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të sigurojë që bursat ndahen në përputhje me rregullat dhe kriteret e vendosura, në mënyrë që procesi të jetë në dobi të atyre që kanë plotësuar kriteret më të përlefërta.	Është bërë rregullorja e re dhe janë zbatuar kriteret e përzgjedhjes së përfituesve.	Rekomandi mi i zbatuar
13	Investime Kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se njësitë kërkuese kuptojnë qartë kërkesat për specifikim teknik të saktë si dhe në rastet e ngjashme, zyrtari i prokurimit duhet të ofrojë këshilla praktike për njësitë kërkuese mbi përmbajtjen e pozicioneve dhe mandej të filloj me proceset e prokurimit.	Njësitë kërkuese kanë specifikuar saktësisht mallrat e nevojshme për blerje.	Rekomandi mi i zbatuar

14	Investime Kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim i brendshëm për të siguruar se Plani i Menaxhimit të Kontratës do të azhurnohet me kohë në bazë të përfundimit të punëve.	Për secilën kontratë është bërë edhe plani i menaxhimit dhe azhurnimi i tij.	Rekomandimi i zbatuar
15	Çështjet e përbashkëta	Kryetari, duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e shpenzimeve, duke siguruar se zotimi i mjeteve bëhet para hyrjes në obligime, dhe faturat paguhen brenda afatit. Po ashtu me rastin e pranimit të mallit të emërohet komisioni përkatës, i cili do të sigurojë që mallrat të përputhen në aspektin e cilësisë dhe sasisë me mallrat e kontraktuara.	Aktualisht, zotimet e mjeteve dhe pagesat bëhen brenda afateve përjashtuar 4 raste.	Rekomandimi i zbatuar
16	Pasuritë kapitale/jokapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë në mënyrë efektive me zyrtarin e pasurive për t'i ofruar dokumente të mjaftueshme lidhur me pasuritë e komunës. Me pas Zyrta i pasurisë duhet të mirëmbajë rregullisht këtë regjistër duke e azhurnuar me të gjitha informatat e kërkuara.	Komuna ka korrigjuar regjistrin e pasurisë.	Rekomandimi i zbatuar
17	Të Arkëtueshmet	Kryetari, duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Po ashtu komuna duhet të shqyrtojë mundësinë e përdorimit të një softueri për menaxhimin e tyre.	Komuna kishte bërë një varg vërejtjesh për tatimpaguesit, mirëpo përsëri niveli i LLA mbetet i lartë krahasuar me vitin paraparak.	Rekomandimi i pa zbatuar
18	Zbatimi i rekomandimeve	Kryetari, duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, me fokus fillestar në fushat e një rëndësie më të madhe. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka nevojë, të propozohen masat adekuate.	Është përgatitur me kohë plani i zbatimit të rekomandimeve dhe është monitoruar. Megjithatë, jo të gjitha rekomandimet janë zbatuar.	Rekomandimi i mbyllur i pa zbatuar.

19	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së dhe të marrë të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar, derisa themelimit të KA duhet t'i jepet rëndësi e veçantë.	NJAB ka bërë 5 raporte finale, për të cilat janë planet e zbatimit të rekomandimeve, si dhe monitorim të tyre. Po ashtu është krijuar KA.	Rekomandimi i zbatuar
20	Raportimi menaxherial	Kryetari, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj strategjinë për menaxhimin e rrezikut me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrollë kërcënimet e ekspozuara.	Kryetari ka mbajtur takime javore, ka procesverbale, mirëpo çështjet e ngritura në raport tregojnë se kjo fushë duhet të trajtohet tutje.	Rekomandimi i pa zbatuar
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Kryetari duhet të angazhohet që gjatë planifikimit të buxhetit për organizatën të vlerësohen nevojat reale të komunës me qëllim që të bëhet një planifikim adekuat i buxhetit dhe të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve nëpër kategori ekonomike.		
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2017 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2018. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Ndërsa, planifikimi dhe shpenzimi për projekteve të caktuara duhet të bëhet konform kodeve ekonomike të ndara për kategori përkatëse varësisht përfitimeve.		
3	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari, duhet të siguroj kontrollë, përgjegjshmëri më të lartë ndaj kryerjes së obligimeve me kohë ndaj operatorëve, si dhe të shmang hyrjen në obligime në mungesë të mjeteve apo kontratës. Gjithashtu, gjatë planifikimit buxhetor, të bëhet një vlerësim i shumave të mundshme të daljes së parasë nga kontestet gjyqësore dhe këto të planifikohen në kuadër të buxhetit vjetor, në mënyrë që mos të rrezikohet realizimi i projekteve tjera të planifikuara.		
4	Pagat dhe mëditjet	Kryetari të sigurojë se janë dizajnuar kontrollet e duhura në mënyrë që rekrutimet të behën përmes një procesi transparent, konkurrues dhe në pajtim me kërkesat ligjore. Në rastet kur ka deficit të burimeve njerëzore, kjo duhet të konsultohet me organet përkatëse qendrore (ministrinë përkatëse) dhe rastet e tilla të rregullohen përmes bazës rregullative.		

5	MSHV	Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.
6	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë mjetet e nevojshme për realizimin e projekteve, në anën tjetër të sigurojë se punëve shtesë iu paraprinë aneks kontrata që përcakton saktë kushtet dhe çmimet e punëve apo shërbimit të përfituar.
7	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë se menaxherët e projektit kërkojnë nga kontraktuesit aplikimin e librit ndërtimor, si mjet për ndërtim dhe zhvillim të projektit.
8	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë se para fillimit të procedurave të janë planifikuar projektet në tërësi, të zgjidhen të gjitha çështjet pronësore, në mënyrë që të mos ketë ngecje të projekteve dhe të pa realizuara.
9	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Po ashtu komuna duhet të shqyrtojë mundësinë e përdorimit të një softueri për menaxhimin e tyre.
10	NJAB	Kryetari duhet të konsiderojë që me krijimin e kushteve buxhetore, të planifikojë staf shtesë në NjAB me qëllim të funksionalizimit të plotë të kësaj njësie dhe të realizimit të planit vjetor. Njëkohësisht, që NjAB të përfshijë më shumë auditime me qëllim të përmirësimit të efikasitetit në procesin e menaxhimit të rrezikut, kontrolleve dhe qeverisjes.
11	Raportimi Menaxherial	Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, të arkëtueshmet, shpenzimet e IK, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të monitorojë listën e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2)

nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi



Dalës-Izlazës

Nr. 11-302

Data 16.04.2019

Br.

Datum

OBILIQ, OBILIC

Republika e Kosovës-Republika Kosovo- Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilic - Municipality Assembly Obiliq



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Obiliqit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Xhafer Gashi, për: 

Data: 16.04 2019, Obiliq,

Kryetar i Komunës së Obiliqit,

